



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.454/18**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**, kryetari i kolegjit-gjyqtari Malsor Kryeziu, me gjyqtarët porot Fahredin Meqa dhe Shpresa Mangjuka dhe me sekretaren juridike të kësaj gjykate Drita Haxhishabani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Xh. (I.) Q. nga Gjakova, rr.”...”, kundër të paditurit Q. (Sh.) T. nga Gjakova, rr.”...” pa nr, për besimin, ruajtjen dhe ushqim të fëmijës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor jo publik në prezencën e paditëses dhe të paditurit, me datë 20.12.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.** Fëmija i mitur A. (Q.) T. data e lindjes .... në Gjakovë, i besohet në ruajtje, mbajtje dhe edukim, nënës së tij, këtu paditëses Xh. Q. nga Gjakova.

**II.** Mbajtja e kontaktit personal të fëmijës së mitur A. T. me të atin këtu të paditurit Q. T. nga Gjakova, mbetet i lirë sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore të palëve ndrgjyqës.

**III.** Secila palë i mbartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja Xh.Q. nga Gjakova, në këtë gjykatë ka ushtruar padi me dt.23.07.2018, kundër të paditurit Q. (Sh.) T. nga Gjakova, për besim, ruajtje, ushqim të fëmijës së mitur të përbashkët.

Paditësja, në seancën kryesore ka deklaruar se ngeli në tërësi pranë theksimeve në padi, kemi jetuar në marrëdhënie jashtëmartesore në muajin gusht 2008. Kurorë nuk kemi pasur dhe në bashkësi jashtëmartesore kemi qëndruar për rreth 1 viti. Nga kjo bashkësi jashtë martesore ka lindur fëmija i mitur i përbashkët A. T. data e lindjes .... Pas kësaj periudhe jeta e përbashkët është bërë e padurueshme dhe me çrregullime serioze dhe jeta e përbashkët është ndërprerë ku paditësja ka vazhduar jetën e saj të pavarur me çrast fëmija i përbashkët i mitur A. T. është në mbikëqyrje të këtu paditëses Xh.Q. I propozoj gjykatës që të aprovohet padia dhe fëmija i mitur të më besohet në ruajtje, kujdes dhe edukim mua si nënë. Kontaktin nuk do të ia ndaloj. Ndërsa në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se qëndroj në tërësi si në deklaratimet e lartë cekura i propozoj gjykatës që të aprovohet kërkesë padia. Nuk i kërkoj shpenzimet e procedurës.

I padituri në seancën kryesore ka deklaruar se e pranoj në tërësi kërkesë padinë e paditëses, propozoj që të aprovohet padia e paditëses. Sa i përket kontaktit e kemi zgjidhur në procedurë jashtë gjyqësore dhe nuk ka nevojë gjykata të vendos për këtë çështje. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se siç theksova edhe me lartë e pranoj padinë e paditëses dhe i propozoj gjykatës që ta aprovohet padia.

Gjatë seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, gjykata administroi si prova: Ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile në Gjakovë, me numër serik ... e lëshuar me dt.... për A. T. raportin nga Qendra për Punë Sociale në Gjakovë, Organit të Kujdestarisë ..., dt.30.10.2018, deklaratës-pëlqimin e dhen nga dekratëdhënësi Q. (Sh.) T..

Kështu që pas vlerësimit të gjithmbarshëm të të gjitha provave të administruara, veçmas si dhe me aplikimin e dispozitave ligjore të parapara me nenin 8 të LPK gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga këto arsye.

Gjykata pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës, bëri vlerësimin e deklaratës së paditëses dhe të paditurit si dhe vlerësimin e provave materiale, gjykata vërtetoi faktin se vërtetë paditësja Xh.Q. ka jetuar në bashkësi jashtëmartesore me të paditurin Q. T.. Të njëjtit kanë jetuar në bashkësi jashtë martesore që nga muaji gusht 2008 e cila ka zgjatur afër 1 viti dhe pastaj e kanë shkëputur këtë bashkësi jashtë martesore. Gjatë bashkëjetesës së përbashkët e kanë lindur fëmijën e mitur A. T. data e lindjes ..., në Gjakovë dhe ky fakt nuk është kontestues. Ky fakt është vërtetuar konkretisht me shikimin në Ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile në Gjakovë, me numër serik ... e lëshuar me dt.... nga e cila vërtetohet se fëmija i mitur A. T. është i lindur nga i ati Q. T. dhe e ëma Xh.Q.

Po ashtu konstatojmë faktin se me njoftimin e shkruar e të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Gjakovë – Organi Kujdestarisë. me numër ..., të dt...., e cila e ka përshkruar anamnezën sociale për paditësen dhe të paditurin, vërtetohet fakti se kjo qendër ka vepruar konform kërkesës së Gjykatës, ku edhe ka dhënë mendimin e saj profesional nga ekipi profesional se i mituri A. T. data e lindjes ..., duhet ti besohet në ruajtje, edukim dhe përkujdes të ëmës së tij Xh.Q. si nënë. Këtij mendimi Gjykata ia falë besimin e plotë.

Pra duke pasur parasysh të gjitha këto prova të administruara si dhe faktet e vërtetuara, gjykata është dashur të vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsyerat se nuk është kontestues fakti se i mituri A. T. është fëmijë i paditëses Xh.Q. që është nëna e tij dhe i padituri Q. T. si babai i tij, po ashtu nuk është kontestuese se fëmija i mitur që nga koha e ndarjes së prindërve jeton me të ëmën këtu paditësen Xh.Q. e cila kujdeset për të. Nga këto rrethana që gjykata i ka vlerësuar, ka konstatuar se fëmija – i mitur A. T. duke pasur parasysh edhe moshën e tij është emocionalisht i lidhur për të ëmën e tij me të cilën edhe bashkëjeton dhe e cila përkujdeset për të miturin A. T. andaj edhe do të ndikoj në zhvillimin më të mirë fizik, psikik dhe në edukim të veçantë të të njëjtit.

Lidhur me kontaktet personale të fëmijëve të mitur me të paditurin Q., duke u bazuar në marrëveshjen jashtë gjyqësore të ndërgjyqësve si dhe deklarimin në seancë, gjykata nuk vendosi lidhur me mënyrën e kontaktit meqenëse ndërgjyqësit kanë arritur marrëveshje gojore dhe në rast se pengohet kontakti nga paditësja, i padituri në çdo kohë mund të parashtrijë padi për rregullimin e kontaktit konform nenit 140 par.3 të LFK.

Nga të gjitha këto arsye të lart konstatuara dhe fakte të vërtetuara, si dhe me aplikimin e dispozitave ligjore të parapara me nenit 139.1, 141 dhe 144 të LFK-së, është dashur të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës bazohet në dispozitat e nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u cekë më lartë është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**C.nr.454/18, me datë 20.12.2018**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari**  
**Malsor Kryeziu**

**UDHËZIME PËR ANKESË:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, dhe atë nëpërmjet të kësaj gjykate.